

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT PËR VITIN 2012

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- KKRT-ja ka arritur të dukshme në zbatimin e kërkesave të Kuvendit të shprehura në rezolutën e vlerësimit të punës së këtij institucioni për vitin 2011.

- Veprimtaria e KKRT-së është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson se:

- KKRT-ja gjatë vitit 2012 ka bërë përpjekje maksimale për realizimin e objektivave që lidhen me zbatimin e kuadrit ligjor dhe ecurinë e institucionit. Vlerësim të veçantë meriton ky institucion për kontributin e dhënë në hartimin e “Strategjisë së kalimit nga sistemi i transmetimit analog në atë numerik”, si dhe ndihmesën teknike në procesin e hartimit të projektligjit “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

- Vendimet dhe aktet e marra nga KKRT-ja kanë përmirësuar ndjeshëm peizazhin audiovizual.

- Në sajë të punës së KKRT-së, tek operatorët radiotelevizivë është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit, lidhur me detyrimet që ata kanë për respektimin e të drejtave të autorit. Shumë operatorë kanë depozituar në KKRT autorizimet me katër agjenci të administrimit kolektiv: AMP, AKDIE, ALBAUTOR, FMAA, si edhe vërtetimin nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit.

- KKRT-ja ka vazhduar të monitorojë kohën e vënë në dispozicion të subjekteve politike nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, zbatimin e kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave, të programacionit etj., duke u treguar korrekte, e paanshme dhe zbatuese e ligjit.

- Si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme të KKRT-së, ka një rritje të ndjenjës së përgjegjësisë ndaj llojshmërisë dhe larmisë së programeve, ndaj cilësisë, si edhe përmbajtjes së tyre.

- KKRT-ja vazhdimisht është përqendruar në rritjen e efikasitetit ndaj luftës kundër piraterisë, duke ushtruar kontrole të vazhdueshme dhe ka vendosur sanksione ndaj shkelësve të ligjit, duke rritur në këtë mënyrë garancitë për një konkurrencë të ndershme.

Kuvendi kërkon nga KKRT-ja:

- Marrjen e masave të nevojshme për të filluar zbatimin efektiv të strategjisë kombëtare për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike;

- Përgatitjen në kohë të akteve nënligjore në zbatim të ligjit të AMA-s;

- Përgatitjen për reformimin institucional dhe të strukturës së re të KKRT-së, në përputhje me kuadrin e ri ligjor të medias;

- Forcimin e kapaciteteve teknike dhe monitoruese të KKRT ;

- Mobilizimin e diskutimeve me komunitetin e gazetarëve, lidhur me çështje të etikës në media;

- Ndërhyrjen më efikase në rastet e piraterisë radiotelevizive dhe të shkeljes së të drejtave të autorit;

- Rritjen e standardeve të etikës dhe funksionimin sa më cilësor të Këshillit të Etikës;

- Vendosjen e një raporti të ri të bashkëpunimit dhe koordinimit institucional me aktorë dhe organe të tjera mbështetëse e zbatuese të ligjit;

- Nxitjen e llojshmërisë së tematikës së programacioneve dhe standardeve të kërkuara;

- Ndërgjegjësimin publik të konsumatorit për procesin e digjitalizimit, si dhe grupeve të interesit, të përfaqësuar nga operatorët e shërbimit audioviziv për sfidat dhe detyrimet ligjore, në kuadër të zbatimit të strategjisë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike;

- Përshtatjen teknike të Studios së Monitorimit, për të përballuar kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike.

Miratuar në datën 2.5.2013

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)